**VENDIM**
**Nr. 276, datë 1.4.2015**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, *SI DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE* TË PRONËS NR. 33, ME EMËRTIM "SHTËPIA E USHTARAKËVE", ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN "ZHANË D'ARK", TIRANË, PËR VENDOSJEN E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR), QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA) *SI DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PATENTAVE DHE MARKAVE (DPPM) E AGJENCISË SË ZBATIMIT TË REFORMËS TERRITORIALE (AZRT).***

*(Ndryshuar me VKM nr. 473, datë 3.6.2015)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, sipas përcaktimeve të mëposhtme, për një periudhë 35-vjeçare, të pronës nr. 33, me emërtim "Shtëpia e Ushtarakëve", me vendndodhje në bulevardin "Zhan d' Ark", Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, *si dhe ministrit të shtetit për Çështjet Vendore,* sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), *si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT).*

*2. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes t'i jepet, në përdorim të përkohshëm, trualli funksional i pronës, bodrumi, kati përdhes, kati i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt i godinës, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për sistemimin e administratës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM). Ndarja e mjediseve të jetë, si më poshtë vijon:*

*a) Bodrumi të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).*

*b) Kati i parë dhe kati i tretë të përdoren nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR).*

*c) Kati i dytë të përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM).*

*ç) Kati i katërt të përdoret nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).*

*2/1. Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore t'i jepet në përdorim të përkohshëm kati i shtatë i godinës, sipas planimetrive dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT).*

*Një pjesë e kësaj hapësire të katit të shtatë të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM), Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT), si ambient i përbashkët për të zhvilluar takime dhe mbledhje pune.*

3. Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike t'i jepet, në përdorim të përkohshëm, kati i pestë dhe i gjashtë i godinës, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

4. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas planvendosjes dhe planimetrive përkatëse, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**





MIRATOHET

Drejtori i [illegible] MMSHP

Znj. Mirela [illegible]

A-06

1 : 100

**Kati 0** OBORR

2715 m² TOT

987 m² sip. e mbulua

1728 m² sip. oborr


Kat
1K0
Kb



2K0
Kb



K-1
Klf
Kr
Kpv




K1
PP
PP
PP


K1


PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
PP
K2


K2
P


K7
PP


K7
PP

*(Shtuar me VKM nr. 473, datë 3.6.2015)*

Planimetri e katit **nëntokë (QKR)** - Sh. 1:175*



Planimetri e katit **përdhe (QKR + QKL) -** Sh. 1:175*





Planimetri e katit **të parë (QKR)** - Sh. 1:100
SHERBIME MBESHTETESE
(34m²)
Specialiste
NYJE H/S
DREJTORIA IT (64m²)
Drejtor + Staf + Ambjent teknik
SERVER (21m²)
kondicionimi?
DREJTORIA E REGJISTRIMEVE (82m²)
Staf + Pergjegjes
LEGJENDE
Mure qe ruhen
Mure gipsi qe shtohen
Mure tulle qe shtohen
Mure qe shemben
Vetrata/dyer qe ruhen
Vetrata/dyer qe shtohen
Vetrata/dyer qe hiqen
Modifikime krahasuar me planimetrite e datës 06.04.2015
07.04.2015

Planimetri e katit **të dytë (QKR)** - Sh. 1:100




PIANO SESTO
LOCALE
SUPERFICIE (mq)
UFFICIO COMITATO CONSULTA MUSICA 24.5
UFFICIO COMITATO CONSULTA LIBRI 34
UFFICIO COMITATO CONSULTA MEDIA E PUBBLICAZIONI 32.8
DIRETTORE 22
MINISTRO 24.5
SALA MEETING 16.2
SEGRETERIA 13.5
Comitato consulta media e pubblicazioni
Ufficio comitato consulta musica
Parete fissa in vetro satinato
Ufficio comitato consulta libri
Sala riunioni
Ministro
Direttore
Segreteria
ascensore 1
ascensore 2
scala in acciaio
PORTE SCORREVOLI
PARETI DEI CORRIDOI RIVESTITE CON PANNELLI PLASTICA OPACA
PARETI DEGLI UFFICI INTONACATE E VERNICIATE
PAVIMENTAZIONE INTERNA: PARQUET
PAVIMENTAZIONE SERVIZI IGIENICI: PIASTRELLE
BASHKIA TIRANE
Instituti Studimeve e Projektimeve te Mbrojtjes
CARCERANO s.p.a.


PIANO TERRAZZA
ascensore 1
ascensore 2
BASHKI,5 TIRANE
CARCERANO s.p.a.